



PSH.nr.809/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina -Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “AOME” SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE N.T.P “Bushgegu 89” - Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim Furnizim me dru për Ngrohje”, me numër të prokurimit: VU 644-20-2120-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK-VUSHTRRI”, më datën: 12.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “AOME” SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me dru për Ngrohje”, me numër të prokurimit: VU 644-20-2120-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - “KK-VUSHTRRI”.

II. ANULOHET, njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin prokurimit me titull: “Furnizim me dru për Ngrohje”, me numër të prokurimit: VU 644-20-2120-1-1-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK-VUSHTRRI”, dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik “AOME” SH.P.K-Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik që konform nenit 31 pika 4 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditës të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “AOME” SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 14.10.2020 me nr. 809/20, kundër njoftimit për dhënien e kontratës lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Furnizim Furnizim me dru për Ngrohje”, me numër të prokurimit: VU 644-20-2120-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –“KK-VUSHTRRI”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 62 dhe 2. paragrafi 1, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe Neni 44 i RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 29.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 29.10.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues - Komuna e Vushtrri, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, me vlerë të madhe. Pretendimet ankimore kane të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës pas ri vlerësimit të ofertave.

Kundër të njëjtit propozim parashtruesi i ankesës në afatin e parapare me LPP, ka paraqitur kërkesë për ri shqyrtim pran AK-s. AK/ Komuna Vushtrri, përmes vendimit, ka refuzuar kërkesën si të pa bazuar kërkesën për ri shqyrtim, me arsyetimin kryesor se OE i ri propozuar për dhënie i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, përkatësisht janë respektuar rekomandimet e vendimit paraprak të PSH-se, nr. 596-20, i datës 18.09.2020.

Përgjigje në pretendimet ankimore (neni 113):

Fillimisht sqarojmë se ky aktivitet i prokurimit ka qenë objekt shqyrtimi në OSHP, palët janë të njëjta, megjithatë parashtruesi i ankesës tani, fillimisht kishte qenë i rekomanduar. OE tani i rekomanduar kishte qenë ankues në ankesën paraprake, rrjedhimisht paneli shqyrtues kishte nxjerr vendim duke obliguar AK – Komuna Vushtrri që lenden ta kthejë në Rivlerësim me kërkesën kryesore se AK, duhet të kërkojë sqarime

shtese për dokumentacionin e kontestuar nga ankuesi për OE te rekomanduar (tani ankues) ne mënyre qe te vërtetohet se OE ne fjale a i plotëson apo jo kërkesën e AK-se, për vërtetimin e APK-se.

Tani parashtruesi i ankesës e konteston arsyetimin e eliminimit, kundrejt kërkesës se kapacitetit teknik dhe profesional qe ndërlidhet me projektet e realizuara ku AK , si dëshmi dokumentare ka kërkuar: “Listën e nënshkruar dhe të vulosur me të cilën specifikohen të gjitha projektet e furnizimeve të ngjashme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara...” Përkundër asaj qe ne kërkesë është potencuar projekte te njëjta ne vlerë prej jo me pak se 160,000 €.

Siç e kemi kuptuar nga gjykimi paraprak i potencuar ne vendimin paraprak për këtë AP, parashtruesi i ankesës, ka prezantuar projekte për furnizime me dru ne vlerën prej 118,808.40 €, dhe vlerën prej 64,591.90 € furnizim me pelet, me këto vlera dhe dëshmi mbulohet kërkesa e AK-se, kundrejt projekteve te realizuara, (AK, ka përcaktuar variant, “njëjta” dhe “ngjashme”).

Sa i përket vërtetimit te APK-se, përkatësisht, përgjigjes se dhen ne AK/ Komuna Vushtrri, si ndaj OE atëherë te rekomanduar, tani ankues, për shkak te pa rregullsive te konstatuara nga inspektoret përkatës, për te njëjtit ka procedure te iniciuar ne organet përkatëse.

Ne vlerësojmë se iniciimi i një procedure ndaj një operatori ekonomik te caktuar, nuk e penalizon apo përjashton nga pjesëmarrja ne një aktivitet te prokurimit apo te kontraktot një pune te caktuar, përkatësisht nuk plotësohen kushtet e përcaktuara ne nenin 65, te LPP-se, për përjashtim nga proceduara e prokurimit apo eliminim te operatorit ekonomik.

Përkundrazi, parashtruesi i ankesës përmes ankesës ka prezantuar kopjen e Aktgjykimit, ku pretendohet se përfaqësuesit e operatorit ekonomik tani te rekomanduar për dhënie te kontratës pas ri vlerësimit te ofertave janë dënuar, për vepër penale Prove: bashkangjitur me raport gjeni kopjen e Aktgjykimit. Përfundimisht, sipas asaj qe u tha si me larte vlerësimi ynë është se për këtë procedure te prokurimit, nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore ne fuqi kundrejt ofertuesve, përkatësisht nuk janë respektuar parimet kryesore për prokurim publik, prandaj propozimi ynë për AK, është qe përmes procesit te ri vlerësimit ti aplikoi ne tërësi dispozitat ligjore, dhe te pasqyroj gjendjen reale te ofertave kundrejt kërkesave te vet aplikuar ne dosje te tenderit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si e bazuar, te anulohet njoftimi për dhënie te kontratës dhe lënda te kthehet ne Ri vlerësim

Organi Shqyrtues i Prokurimit me datën 29.10.2020 ka njoftuar palët me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues me datë 02.11.2020, me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-në:

Te nderuar e kemi pranuar Ekspertizën e Ekspertit. Te njëjtën, me kujdes, e kemi analizuar. Lidhur me te gjeturat e Ekspertit, te konstatuara dhe ne Ekspertizën me shkrim, ne si A.K. sqarojmë se nuk pajtohemi ne tërësi me konstatimet e Ekspertit shqyrtues te dhëna ne Ekspertize. Për argumentet ligjore dhe faktet mbi te cilat A.K. asht mbështetur kur ka marre një vendim te tille ne do ti paraqesim para panelit shqyrtues gjate seancës e cila do te caktohet te mbahet ne ditët ne vijim. Ne kërkojmë nga OSHP qe te na ofrohet mundësia për pjesëmarrje me rastin e mbajtjes se seancës ne mënyre qe para panelit ti paraqesim argumentet dhe provat tona, ne mënyre qe panelit ti ofrojmë një pasqyre sa me reale lidhur me qeshjet e ngritura ne ketë proces, si dhe paneli te ketë sa me lehte një vendimmarrje sa me te drejte Ashtu siç besoj jeni ne dijeni se Operatori Ekonomik ankues fillimisht nga ne si AK ka qene i rekomanduar për dhënie të kontratës, por sipas ankesës në OSHP, të një OE tjetër po ashtu pjesëmarrës në ketë aktivitet te prokurimit lënda në fjalë është trajtuar nga OSHP dhe bazuar në vendimin e OSHP komisioni i ri vlerësimit i AK-së ka rekomanduar për dhënie te kontratës OE të përgjegjshëm Ne si AK presim që kjo lende të trajtohet me urgjencë duke pas parasysh se jemi në prag të sezonit dimëror dhe lënda drunore është e domosdoshme për të funksionuar shkollat dhe institucionet tjera të cilat ngrohen me lenden drunorë të paraparë për furnizim me ketë aktivitetin Me respekt,DPP –VU.

Operatori Ekonomik me datë 26.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në: Përshëndetje të nderuar,

Me datë 29/10/2020 kemi pranuar raportin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së me numër të protokollit [809/20](#), të datës 29/10/2020. -Raporti i ekspertit shqyrtues që ka të bëjë me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me dru për ngrohje" me numër të prokurimit: [644-20-2120-1-1-1](#), të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Komuna Vushtri, është i hartuar mirë dhe në mënyrë profesionale, faktikisht i ka trajtuar mjaft mirë të gjitha pretendimet ankimore të cilat ne bazuar në fakte i kemi parashtruar në ankesë Ne pajtohemi në tersi me raportin e hartuar nga ana e ekspertit shqyrtues Mbetet që në seancën e shqyrtimit kryesor të panelit shqyrtues të OSHP-së, ku do të jetë i pranishëm edhe zyrtari ynë i autorizuar dhe pas shqyrtimit të këtyre pretendimeve ankimore si dhe pas analizimit të raportit të ekspertit shqyrtues edhe një herë, të nxirret një vendim meritor Gjithashtu konsideroj se seanca e panelit shqyrtues do të caktohet me prioritet, sa më shpejt që të jetë e mundur, sepse veç sezoni dimëror për ngrohje ka filluar Ju faleminderit për mirëkuptim.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit

të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "AOME" SH.P.K-Prishtinë, se është eliminuar kundrejt kërkesës së kapacitetit teknik dhe profesional që ndërlidhet me projektet e realizuara. AK si dëshmi dokumentare ka kërkuar: "Listën e nënshkruar dhe të vulosur me të cilën specifikohen të gjitha projektet e furnizimeve të ngjashme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara..." Përkundër asaj që ne kërkesë është potencuar projekte të njëjta në vlerë prej jo më pak se 160,000 €.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në vendimin paraprak për këtë aktivitet të prokurimit, parashtuesi i ankesës ka prezantuar projekte për furnizime me dru në vlerën prej 118,808.40€, dhe vlerën prej 64,591.90€ furnizim me pelet. Me këto vlera dhe dëshmi mbulohet kërkesa e AK-së kundrejt projekteve të realizuara (AK ka përcaktuar variant "njëjta" dhe "ngjashme").

Sa i përket vërtetimit të APK-së, përkatësisht përgjigjes së dhënë në AK/ Komuna Vushtrri, si ndaj OE atëherë të rekomanduar, tani ankues, për shkak të pa rregullsive të konstatuara nga inspektorët përkatës, për të njëjtit ka procedurë të iniciuar në organet përkatëse.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se se inicimi i një procedure ndaj një operatori ekonomik të caktuar nuk e penalizon apo përjashton nga pjesëmarrja në një aktivitet të prokurimit apo të kontraktos një punë të caktuar, përkatësisht nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 65 të LPP-së, për përjashtim nga proceduara e prokurimit apo eliminim të operatorit ekonomik.

Në anën tjetër, OE ankues "AOME" SH.P.K-Prishtinë përmes ankesës ka prezantuar kopjen e Aktgjykimit, ku pretendon se përfaqësuesit e operatorit ekonomik tani të rekomanduar për dhënie të kontratës se pas ri vlerësimit të ofertave janë dënuar për vepër penale, ku eksperti shqyrtues ka bashkangjitur kopjen e aktgjykimit dënues.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, si dhe duke pasur parasysh ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, vjen në përfundim se për këtë aktivitet të prokurimit, nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore në fuqi kundrejt ofertuesve. Përkatësisht, nuk janë respektuar parimet kryesore për prokurim publik. Për më tepër, Paneli Shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë është rekomanduar për kontratë në kundërshtim me nenin 65 të LPP-së pasi që drejtuesit e saj janë dënuar nga gjykata kompetente. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konstaton se AK nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që gjatë

ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve të veproj në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së, në veçanti me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-VUSHTRRISE";
- 1x1 OE "AOME" SH.P.K-Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.